



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1260 / Prot.
3

Tiranë, më 27 / 10 / 2020

V E N D I M

Nr. 23 datë 27 . 10 . 2020

P Ë R

MIRATIMIN E PAGESËS SË ANËTARËVE TË JASHTËM TË JURISË PËR
MBROJTJEN E GRADËS SHKENCORE "DOKTOR"

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM-në nr. 112, datë 23.02.2018 "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standarteve për fitimin e titujve akademik "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor", pika 11, Udhëzimin nr. 29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë", Kreu II, pika 12, vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 të Bordit të Administrimit "Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës", si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit nr. 151/4 prot, datë 12.10.2020, Bordi i Administrimit i UPT-së,

V E N D O S I:

1. Të miratojë pagesën për personelin e njëjësive bazë nga institucione homologe vendase ose të huaja, që angazhohen si anëtarë të jashtëm në juritë për mbrojtjen e gradës shkencore "Doktor" dhe juritë për fitimin e titujve akademik, në Universitetin Politeknik të Tiranës.
2. Masa e pagesës të përlogaritet për 10 orë mësimi, sipas kategorisë përkatëse të personelit të angazhuar.
3. Ngarkohet Administratori i Institucionit, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

K R Y E T A R I

Arben DHIMA

